



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KUVENDI I KOMUNËS** **KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA**

### **Procesverbal i mbajtur më 28 mars 2024, në mbledhjen e XXII-të (njëzetedy) mandati VII-të i Komitetit për Politikë dhe Financa.**

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në ndërtesën e re të Komunës, dhe filloi në orën 10:10

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti, dhe atë; (Naim Çunaku; Arnisa Sylejmani; Haki Rudari; Drita Pajaziti; Sebastina Vokrri; Bashkim Sylja; Mrika Thaçi kurse mungoi Qëndrim Softolli) bashkëngjitur lista e nënshkrimeve.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje i pranishëm ishte edhe; *Fatlum Osmani drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF; Avni Fetahu Drejtor i Drejtorisë së Arsimit-DKA; Adelina Stublla Drejtoresh e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS; Leutrim Krasniqi drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit-DPUMM; Saranda Stublla drejtoresh e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë-DPKGJ; Vigan Salihu drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik-DPZHE;*

### **Rendi i ditës**

**z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit**, e hapi mbledhjen përshëndeti të pranishmit, konstatoi kuorumin, theksoi, materialin e keni marrë me kohë besoj edhe pse po kemi probleme me dërgimin e materialeve tek disa anëtar/e të Kuvendit për shkak të e-maileve të tyre, sidomos tash së fundmi me e-mailet zyrtare të cilat si duket janë në kapacitetin e tyre dhe nuk mund të pranojnë më shumë për shkak të kapacitetit të tyre të pamjaftueshëm, andaj është mirë që zyrtarët përkatës të Komunës t’jua rifreskojnë e-mailet e juaja zyrtare në mënyrë që të shkarkohen apo t’iu rritet kapaciteti për të pranuar materialet e mbledhjeve.

**znj.Drita Pajaziti**, theksoi, edhe unë mendoj se ka probleme të tilla që u përmenden me e-mailet zyrtare dhe atë për shkak të kapacitetit jo të mjaftueshëm të tyre për pranimin e materialeve, andaj do të ishte mirë të merren veprime për rritjen e kapacitetit të e-maileve zyrtare në mënyrë që të mund të pranojmë materialet e seancave.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, i nderuar Kryesues, sa na tregon neve për kapacitetin e e-maileve zyrtare tonat, jeni Kryesues i Kuvendit dhe mund t’i drejtohem Zyrës së IT e cila merret me këtë çështje dhe ta rregullojnë këtë problem.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, është e vërtetë ajo që e potencon parafolësi mirëpo nuk e di se a mund të ndërhyjnë Zyra e IT sepse e-mailet kanë edhe Passwordet e që nuk mund të kenë qasje pa qenë prezent edhe ne anëtarët e Kuvendit, përndryshe zyrtarë të Zyrës së IT janë edhe këtu prezent dhe mund ta marrin këtë si kërkesë apo shqetësim që e paraqitëm, por sa jam në dijeni edhe zyrtari i Zyrës Ligjore jua ka dërguar një e-mail Zyrës së IT lidhur me këtë problematikë, dhe i cili çdo herë mundohet që t’ju pajisë me materiale të seancave dhe jo vetëm qoftë edhe në e-mailet private për të cilat po ashtu në disa raste për

shkak të kapacitetit të e-maleve private po ashtu paraqiten probleme me dërgimin e materialeve, kështu që jemi munduar çdo herë të bëjmë zgjidhje dhe të mos paraqiten problematika të tilla.

**z.Avni Fetahu**, drejtor i Drejtorisë së Arsimit, në emër të Ekzekutivit të Komunës dhe në cilësinë e anëtarit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB, theksoi, meqë ish Komandanti i Stacionit të Policisë në Podujevë z.Nijazi Jashari ka shkuar në pension, kurse tani me një Vendim të Ushtruesit të Detyrës është emëruar z.Bashkim Bajrami Komandant i Stacionit të Policisë në Podujevë, kërkohet plotësim ndryshimi i vendimit për themelimin dhe përbërjen e KKSB në Podujevë, andaj propozoj që kjo çështje të hyjë fillimisht në rend të ditës për këtë mbledhje dhe t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim në mënyrë që në mbledhjen e radhës të bëhet ky plotësim ndryshim.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, e falënderoj drejtorin parafolës për këtë propozim, konsideroj se edhe zyrtarisht duhet të bëhet ky plotësim ndryshim i përbërjes së KKSB-së pas shkuarjes në pension të ish komandantit të Stacionit të Policisë, emërimit të Komandantit të ri e që tani duhet të zëvendësohet kjo pozitë në KKSB, andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë propozim që të hyjë në rend të ditës për këtë mbledhje.

*Njëzëri me 7 vota Për, nga anëtarët që ishin prezent, mbështetet propozimi i z.Avni Fetahu Drejtor i Drejtorisë së Arsimit dhe njëkohësisht anëtar nga Ekzekutivi i Komunës në KKSB, që në kuadër të rendit të ditës të përfshihet si pikë shtesë edhe:*

**-Plotësim ndryshimi përbërjes së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi-KKSB, përkatësisht z.Bashkim Bajrami Komandant i Stacionit të Policisë në Podujevë, të jetë anëtar në kuadër të përbërjes së KKSB në vend të ish Komandantit z.Nijazi Jashari i cili është pensionuar.**

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi,

*Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 8 vota Për, nga anëtarët që ishin prezent, miratohet rendi i propozuar i ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, përfshirë edhe pikën shtesë të mbështetur paraprakisht.*

## **1. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-00594-0, ZK Turuçicë**

*1.1. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*

**Kryesuesi i Kuvendit**, theksoi, kemi të bëjmë me propozim vendime për dhënien në shfrytëzim të pronave të Komunës. Në fakt këto pika të rendit të ditës ka qe 3 mbledhje që procedohen dhe heqen nga rendi i ditës për shkak të mos aplikimeve të Shoqërisë Civile në komisionet përkatëse vlerësuese, andaj fjalën hyrëse i'a jap drejtoreshën e DPKGJ.

**znj.Saranda Stublla**, drejtoresh e DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike, theksoi, si pikë të rendit të ditës është propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-00594-0, ZK Turuçicë si dhe propozim vendimin për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim të kësaj prone, prandaj nga ana juaj kërkoj që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim në seancën e thirrur për ditën e nesërme.

**z.Haki Rudari**, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së e përkrahim këtë pikë të rendit të ditës, përkatësisht këtë propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-00594-0, ZK Turuçicë përfshirë edhe propozim vendimin për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim të kësaj prone. Konsiderojmë se është e rëndësishme dhe qëllimi është i mirë qoftë në kuptimin ligjor qoftë për rritjen e të hyrave vetanake të Komunës, kështu që si grup i LVV-së e përkrahim dhe i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim dhe miratim në seancën e radhës.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, i nderuar Kryesues duke pasë parasysh që këto pika ashtu siç e ceke edhe vet në fillim janë përsëritur disa herë, ne edhe në të kaluarën i kemi mbështetur por edhe tani i mbështesim, andaj nuk po dëshiroj të marrë kohë as për arsyeshmërinë e as për nevojën që të jepen në shfrytëzim pronat përkatëse, mirëpo do ta kenë përkrahjen sërish dhe uroj të mos del sërish ndonjë pengesë nesër në Kuvend shkaku i mos aplikimit të OJQ-ve në komisionet vlerësuese.

**znj.Arnisa Sylejmani**, pyetje drejtoreshës së DPKGJ, theksoi, a ka të paraqitur nga Shoqëria Civile për të qenë pjesë e komisioneve vlerësuese.

**znj.Saranda Stublla**, drejtoresh e DPKGJ, theksoi, afati i paraqitjes së nominimeve nga Shoqëria Civile është edhe sot dhe nuk ka të paraqitur, mirëpo do të shohim deri nesër se a do të paraqiten nga OJQ-të.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, urdhëroni nëse ka të lajmëruar për të marrë fjalën rreth kësaj pike, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës.

*Njëzëri me 7 votë Për nga anëtarët që ishin prezent në sallë, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të propozim vendimit për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-00594-0, ZK Turuçicë, sipas materialit të kësaj pike dërguar me thirrjen e mbledhjes.*

*Njëzëri me 8 votë Për nga anëtarët që ishin prezent në sallë, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të propozim Vendimit për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim, sipas materialit të kësaj pike dërguar me thirrjen e mbledhjes.*

## **2. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-00596-0, ZK Turuçicë**

### **2.1. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim**

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, urdhëroni nëse ka të lajmëruar për të marrë fjalën rreth kësaj pike, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës, pra nëse jeni të pajtimit të dyja në pako.

*Njëzëri me 8 votë Për nga anëtarët që ishin prezent në sallë, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të propozim vendimeve përkatëse sipas materialit të kësaj pike dërguar me thirrjen e mbledhjes.*

### **3. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-00597-0, ZK Turuçicë**

*3.1. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim*

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, urdhëroni nëse ka të lajmëruar për të marrë fjalën rreth kësaj pike, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës, pra nëse jeni të pajtimit të dyja në pako.

*Njëzëri me 8 votë Për nga anëtarët që ishin prezent në sallë, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të propozim vendimeve përkatëse sipas materialit të kësaj pike dërguar me thirrjen e mbledhjes.*

### **4. Nisma për bashkëpunim ndër-komunal mes Komunës së Podujevës me Komunave:**

Komuna e Vushtrrisë; Komuna e Prishtinës; Komuna e Mitrovicës së Jugut dhe Komuna e Obiliqit

*4.1. Propozim vendimi për miratimin e kërkesës – nismës për themelimin e bashkëpunimit ndër - komunal*

*4.2. Propozim vendim për autorizimin e Kryetarit të Komunës për fillimin e konsultimeve për themelimin e bashkëpunimit ndër - komunal*

**z.Leutrim Krasniqi**, drejtor i DPUMM, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, në kuadër të kësaj Nisme planifikohet fillimisht që të bëhet një studim i fizibilitetit për ndërtimin e rrugës regionale e cila do të fillon nga fshati Barilevë duke vazhduar pastaj në pjesën e fshatrave Kozaricë e kështu me radhë, por që si tërësi i përfshinë 5 Komuna.

Komuna e Vushtrrisë ka nxjerrë një Vendim nga Kuvendi i Komunës për vazhdimin e kësaj Nisme, andaj edhe ne si komunë e Podujevës rekomandoj që ta aprovojmë këtë Nismë në Kuvendin e Komunës në mënyrë që të vazhdohet pastaj me procedurat për studimin e fizibilitetit fillimisht dhe pastaj edhe me procedurat tjera që kanë të bëjnë me realizimin e projektit. Normale që në bazë të kësaj parashihet participimi i 5 Komunave së bashku me Ministrinë e Infrastrukturës.

Ndoshta një prej pyetjeve që do të mund të shtrohet nga ana juaj dhe që und të diskutohet edhe në Kuvend, mund t'ju them se për momentin trase të rrugës nuk ka, vetëm se është si ide që të jetë në kuadër të kreshtave malore apo në pjesën më të lartë të maleve prej pjesës së Barilevës dhe të vazhdoj deri në pjesën e Bajgorës, që të ndërtohet një rrugë e re regionale lidhëse për këto Komuna.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, nga ajo që e prezantoi drejtori parafolës, po e ndjejë vetën paksa të mangët sepse në kuptimin gjeografik e di që Komuna jonë për pikëpamje gjeografike kemi ekspertë eminent, mirëpo më bëri përshtypje që ato fshatra që u potencuan me radhë duke filluar nga Barileva, Kozarica, Brezhticë e të tjera por që nuk u përmend asnjë territor i komunës së Podujevës, dhe pa dashtë të vë në dyshim se ajo artere mund të hyjë në funksion edhe të Komunës së Podujevës, mirëpo pyetja është se si territor a e prek territorin e Komunës së Podujevës ajo rrugë, përndryshe nëse nuk e prekë territorin tonë atëherë përse ne jemi të nevojshëm të jemi pjesë e kësaj, Qeveria është në Rregull që të jetë pjesë e ndërtimit të kësaj rruge, mirëpo Komuna pse.

**z.Leutrim Krasniqi**, drejtor i DPUMM, theksoi, siç e cekta paraprakisht trase ekzakte të rrugës nuk ka, mirëpo me studimin e fizibilitetit mund të parashihet që të preket territori i Komunës së Podujevës, sidomos fshatrat duke filluar nga Lupç i Poshtëm, Majac, Lupç i Epërm, dhe Popovë, pra këto janë 4 fshatra pretendente që mund të preken nga jo trase e kësaj rruge, mirëpo ekziston mundësia që të preken vetëm 1 apo 2 fshatrat edhe pse kjo tani për tani është vetëm si ide për t'i filluar procedurat e studimit të fizibilitetit, dhe në kuadër të këtij studimi do të bëhet një analizë më e favorshme për realizimin e ndërtimit të kësaj rruge.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, nuk kam qëllim polemizimi por vetëm në kuptim të sqarimit, kur u përmend fshati Brezhticë dhe pastaj të kthehet këndej nga fshatrat Majac e Popovë, mund të them se atë territor e njoh sepse jam nip i tyre, mirëpo nëse mendoni si projekt ideor, të mos merret kjo që unë jam kundër sepse jam për dhe përkrah çdo projekt të tillë që lidh Komunën tonë me Komunitet tjerë fqinjë si motra dhe fare nuk mendoj se nuk duhet të participohet në kuptimin e fqinjësisë, mirëpo në kuptimin gjeografik nëse nuk jemi në territorin e kësaj rruge atëherë i nderuar drejtor i DPUMM kam një pyetje shtesë, a do të ishte më e arsyeshme kjo rruga Llapashticë – Popovë dhe vazhdon andej, apo siç është quajtur në të kaluarën “Rruga e Banovines”, pra po të ishte kjo rrugë si mundësi atëherë vërtetë do ta lidhte Komunën tonë me një qasje nga fshati Llapashticë, ndërsa ajo pjesa që e përmendet tek Lagja Pireva e që edhe aktualisht është një rrugë por që është e një tjetër niveli por që lidhet kjo Lagje me Brezhticën, Kozaricën, Stanofcin e të tjera që nuk i përmbush kriteret për të qenë rrugë regjionale.

Pra unë jam për këtë rrugë që po diskutohet, por nëse Komuna jonë vendos që kjo rrugë të bëhet si një arterie e re atëherë në një formë po sugjeroj drejtorin e DPUMM që ta ketë në mendje këtë rrugën e quajtur “Rruga e Banovine” e cila do të ishte shumë më efektive për Komunën e Podujevës.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, unë kam një vërejtje rreth kësaj rruge, përse nuk është përfshirë edhe Komuna e Leposaviçit në këtë trase sepse është në vijë kufitare me Komunitet tjerë. Pra ne jemi në dijeni se edhe Komunitet kanë kufij dhe jemi në dijeni se Komuna e Leposaviçit e ka kufirin me neve tek fshati Murgull.

**z.Haki Rudari**, theksoi, t’ju them të drejtën fort nuk po më pëlqen kjo “Rruga e Re” sepse për një rrugë të re del punë dhe ka punë deri te ndërtimi, por si do që të jetë po pajtohemi që është një bashkëpunim ndërkomunal, dhe tani ajo traseja që u përmend nga drejtori i DPUMM nga Barileva deri në Bajgorë realisht dhe sigurisht lidhë edhe Komunën e Podujevës sepse kemi pjesën e Popovës, Segaqës e të tjera, por mendoj se lidhet ndokund, andaj unë vetëm lus që të realizohet kjo rrugë për arsye se edhe rrugët tjera i liron paksa nga komunikacioni. Madje duke parë edhe pjesën e Bajgorës ku vërehet niveli i turizmit, mendoj që kjo rrugë vetëm i kontribuon qytetarëve të kësaj pjese qoftë në aspektin e turizmit qoftë edhe aspekteve tjera agroturizëm apo agrobizneseve duke qenë në dijeni se pjesa e Bajgorës ka shumë veçori dhe kapacitete të zhvillimit të turizmit qoftë verorë qoftë dimërorë.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, Bajgora ka një rrugë e cila lidhet me Mitrovicën, unë e ceka edhe më parë që jemi për këtë projekt e në veçanti kur përmendet rruga e re nuk mund të jem kundër, mirëpo ajo që deshta të vë në spikam është se është mirë të merret parasysh i nderuar drejtor i DPUMM që rruga e cila lidhet me fshatin Llapashticë do të shtonte shumë funksionalitetin edhe tek rruga e fshatit Bajgorë ku veç ekziston një rrugë në atë pjesë. Pra kjo që e them ka për qëllim që rruga që do të ndërtohet t’i përkushtohet sa më shumë të jetë e mundur qytetarëve tanë, pa dashur të keqkuptohem për këtë si projekt sepse rruga e re është rrugë e re dhe duhet të trasohet.

**z.Bashkim Sylja**, theksoi, lidhur me këtë propozim vendim, fillimisht ne të gjithë jemi në dijeni se kemi lidhje të ndryshme me Mitrovicën ku edhe e kemi rrugën aktuale që i bie për Bajgorë, pastaj edhe për Vushtrri kemi rrugën e cila lidhet nga Lagja Pireva në Lupç për fshatin Stanofc dhe dalim në Vushtrri, mirëpo lidhur me këtë propozim vendim kemi të bëjmë me një rrugë regjionale e cila lidh 4-5 komuna siç janë Prishtina, Podujeva, Obiliqi, Vushtrria dhe Mitrovica, andaj mendoj se fillimisht do të përcaktohet traseja e kësaj rruge përmes studimit të fizibilitetit ku edhe do të zgjidhet pozita më e mirë e mundshme e që sigurisht se do të preken këto Komuna, kurse pastaj lidhjet dhe arteriet kryesore që lidhen nga këto Komuna drejtë qyteteve të cekura veç janë por edhe do të ndërtohen edhe tjera.

Pra kemi të bëjmë me një rrugë apo trase regjionale e cila do të lidhë më shumë se dy Komuna.

**z.Leutrim Krasniqi**, theksoi, në një formë e përmendi edhe parafolësi z.Bashkim Sylja se qëllimi i kësaj rruge është që fillimisht arteria kryesore të trasohet, kurse pjesët tjera sekondare mundën t'i ndërtojnë edhe vet Komunitat. Nuk do të thotë që është e nevojshme gjithsesi që ajo rrugë të prek një territor të Komunës kurse parashihet me fizibilitet që kostoja e saj do të jetë më e ulët në realizim në qoftë se traseja është me një hapësirë ose një zhvendosje të caktuar më shumë në një komunë e më pak në një komunë tjetër, prandaj kjo në një formë do të jetë studimi i fizibilitetit që do të bëhet.

Sa i përket rrugës Llapashticë – Popovë që e përmendi z.Naim Çunaku, ne veç se kemi menduar për këtë më herët dhe kemi dërguar kërkesën në Ministrinë përkatëse ku sipas thirrjes së tyre për financim të projekteve janë të ndara rreth 17 milion euro, pra projekti është bërë dhe komplet kostoja e saj është 1.4 milion euro. Pra fillimisht ne si Komunë do ta ndërtojmë rrugën prej pjesës së Llapashticës deri në Popovë kurse pjesa tjetër do të jetë pjesë e iniciativës që është nga Komuna e Vushtrrisë. Sigurisht se në atë thirrje të Ministrisë ka edhe kërkesa të Komunave tjera por besojmë se do të shqyrtohet si mundësi për mbështetje për realizimin e kësaj rruge.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, besoj se gjitha diskutimet janë me qëllimin më të mirë se qysh të arrijmë që edhe Komuna jonë të përfitoj prej kësaj rruge, kështu që urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e vëm në votim këtë pikë të rendit të ditës ku pjesë e saj janë dy propozim vendime që janë pjesë e Nismës për bashkëpunim ndër-komunal mes Komunës së Podujevës me Komunave Vushtri; Prishtinë; Mitrovicë e Jugut; Obiliq, dhe atë:

*-Propozim vendimi për miratimin e kërkesës – nismës për themelimin e bashkëpunimit ndër - komunal*

*-Propozim vendim për autorizimin e Kryetarit të Komunës për fillimin e konsultimeve për themelimin e bashkëpunimit ndër - komunal*

*Njëzëri me 8 votë Për nga anëtarët që ishin prezent në sallë, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të propozim vendimeve përkatëse sipas materialit të kësaj pike dërguar me thirrjen e mbledhjes.*

## **5. Raporti Vjetor Financiar i Komunës së Podujevës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023**

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF, e paraqiti raportin në fjalë, theksoi, bëhet fjalë për pasqyrat financiare e cila dërgohet edhe në Ministrinë e Financave, por e kemi për obligim ligjor ta prezantojmë edhe në Kuvendin e Komunës, kështu që rekomandoj që kjo pikë e rendit të ditës të kaloj për diskutim në mbledhjen e Kuvendit.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, një prej çështjeve më të rëndësishme që një Kuvend i Komunës brenda një viti e diskuton, për mendimin tim është miratimi i buxhetit si dhe kontrolli, monitorimi, mbikëqyrja se si është shpenzuar ai buxhet, a i ka mbërritur objektivat e parapara në buxhet, sa ka arritur që me nikoqirllëk të shpenzohet, cilat janë ato projekte që janë realizuar andaj në një formë të drejtë atë që e ka një qeverisje e mirë e që dy segmentet kryesore të një qeverisje të mirë janë llogaridhënia dhe transparenca dhe nisur nga këto dytribute që i ceka për ta kualifikuar një qeverisje të mirë, dhe nga fjala që e dëgjova drejtorin e DBF e që vërtetë e përkrahë sepse ashtu është, ky raport vetëm një kriter e përmbushë që është një obligim ligjor i Komunës, ndërsa sa i përket transparencës dhe llogaridhënies është shumë larg nga e dëshiruara.

Ndoshta e kemi bërë të tepërt duke e përmend përvojën në Kuvend, mirëpo vërtetë një raport i tillë me kaq mangësi sqaruese për ata që i'u paraqitet, nuk më ka hasë ta lexoj dhe ju lus të hyni në faqet e Komunave tjera dhe vetëm bëjeni një krahasim se çfarë paraqesin dhe pasqyrojnë raportet financiare të komunave tjera dhe çfarë e kemi ne sot.

Për detajet e këtij raporti sigurisht se do të debatojmë nesër në Kuvend, jam në dijeni se nuk votohet por ka nevojë të jetë më sqarues për përfaqësuesit e qytetarëve gjegjësisht për kuvendarët që t'ju bëjë

transparente si, ku, çka dhe sa me nikoqirllëk është shpenzuar ai buxhet, sa ka mbetje, sa ka borgje, sa janë të ardhurat nga Organizatat Ndërkombëtare të cilat fare nuk pasqyrohen në këtë raport, vërtetë për mua është një raport shumë i mangët e që do ta sfidojmë nesërme mbledhjen e Kuvendit.

**znj. Sebastina Vokrri**, theksoi, ne Grupi i LVV-së e përkrahim këtë pikë të rendi të ditës, përkatësisht raportin vjetor financiar të Komunës së Podujevës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023, që t'i rekomandohet Kuvendit për mbledhjen e radhës.

**z. Bashkim Sylja**, theksoi, raporti financiar është e vërtetë se ka ndryshuar formë për dallim nga e kaluara qoftë nëse janë hartuar nga Komuna apo nga Ministria, dhe atë ndryshimet janë që dy vite, pra paraqitet paksa më problem dhe mendoj se sqarimet dhe informata janë më gjysmake si dhe nuk pasqyrohen të gjitha, mirëpo nesër në mbledhjen e Kuvendit do të diskutojmë gjerë rreth këtij raporti.

**znj. Arnisa Sylejmani**, theksoi, sa i përket raportit vjetor financiar të Komunës së Podujevës për vitin 2023, nëse do e përgjedhja vetëm një fjali me të cilën do ta përshkruaja komplet këtë raport, është në ekstrem i pakuptueshëm, do të thotë nëse nuk je i fushës përkatëse do ta kesh të pamundur ta shikosh se çfarë kanë bërë në këtë raport financiar për vitin 2023. Madje të paktën keni mund ta bëni për të lehtësuar leximin që të vendosni disa bordera ose vija kufizuese në mes të kategorive.

**z. Fatlum Osmani**, drejtor i DBF, theksoi, raportet periodike të cilat prezantohen para Kuvendit të Komunës janë me një formë dhe një standard që pak a shumë e përgatit Komuna se qysh dëshiron ta paraqes, ndërsa kur bëhet fjalë për raportin vjetor financiar dihet se pasqyra financiare për vitin 2023 është një format i Ministrisë së Financave, edhe formati i pasqyrave financiare është i Ministrisë së Financave e që do të thotë se ka pësuar disa ndryshime qoftë teknike qoftë tjera.

Pra kjo është pasqyra financiare e Komunës së Podujevës të cilën deri më 31 dhjetor 2023 jemi të obliguar ligjërisht ta dërgojmë në Ministrinë e Financave dhe njëkohësisht ky është raporti financiar dhe pasqyra financiare e cila po ashtu i nënshtrohet analizës dhe raportit të Auditorit, dhe mbi bazën e kësaj pasqyre e cila është prezantuar Komuna e Podujevës merr një raport nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Do të thotë është pasqyra financiare e formatit të Ministrisë së Financave e aprovuar dhe që e ka për obligim ligjor çdo organizatë buxhetore të raportoj pasqyrat financiare në këtë formë. Pra dorëzohet në Thesar dhe njëkohësisht i njëjti dokument auditohet nga Zyra Kombëtare e Auditorit.

**znj. Arnisa Sylejmani**, theksoi, i nderuar drejtor i DBF-së, edhe pse këtu nuk dëshirojmë të bëjmë debat, por vetëm po i shprehim mendimet tona e që sigurisht se nesër në mbledhjen e Kuvendit do t'i paraqesim secili mendimet e veta personale, se si duhet të paraqitet një raport financiar paksa më i kuptueshëm për ata të cilët nuk janë profesionist të fushës.

**z. Bashkim Sylja**, theksoi, unë vetëm deshta të marrë një sqarim nga drejtori i DBF-së, unë pothuajse rreth 60% - 70% e kam kuptuar këtë raport mirëpo mënyra se si është formuluar ky raport nuk e di a është apo jo standard i Ministrisë së Financave ky format, shembull, te realizimi i të hyrave tatimore janë 666,000.00€, pastaj kemi buxhetin final dhe atë fillestar, ju keni planifikuar 758,000.00€ të hyra, prandaj përse të shkruhet buxheti final, kurse realizmi është 666,000.00€, kurse buxheti final thuhet se janë 758,000.00€. Pra kemi mbi 90,000.00€ më pak të hyra se sa që janë planifikuar, prandaj për këto çështje ka disa prej tyre që janë të pakuptueshme, madje ka të tilla që as unë nuk i kuptoj sepse nuk jam i fushës mirëpo përvoja në Kuvend na e mundëson të kuptojmë paksa më shumë.

Pastaj tek të hyrat tatimore kemi 1 milion e 75 mijë euro, kurse janë planifikuar 1 milion e 48 mijë euro, do të thotë janë tejkaluar.

**z. Naim Çunaku**, theksoi, në kuptimin që kur ekziston vullneti të bëhet një punë dhe kur merret ajo punë sigurisht se dihen arsyetimet si do që bëhet ajo punë, mirëpo poenta ishte ajo që të raportohet për t'ia sqaruar dikujt për diçka, pra baza e raportit është se kërkon t'i raportosh gjegjësisht ta njoftosh dikë, dhe në vazhden e asaj të përmbushjes ligjore kur Ekzekutivi i Komunës e paraqet raportin, prandaj jo vetëm

për mua por është një raport total i pakuptueshëm dhe i pasqarueshëm për pjesën dërmuese sepse nuk jemi të gjithë me profesion të ekonomisë ose të kontabiliteteve, mirëpo si raport është shumë i mangët.

Lidhur me atë që kolegu parafolës z.Bashkim Syla e ceku se nuk e di a është standard ky format i raportit, mendoj se edhe standardi e ka një limit deri ku, prandaj në diskutimin tim të mëparshëm e potencova që mund të krahasoni këtë raport me raportet financiare të komunave tjera dhe mund ta shihni ndryshimin.

Drejtori i DBF përmendi dy elemente të cilat më bënë të marrë fjalën për të dytën herë, pra e tha se raportet periodike financiare janë të paraqitura para Kuvendit në një formë tjetër, mirëpo i nderuar drejtor a jeni në dijeni se ne nuk kemi pas raport fare për tremujorin e tretë të vitit të kaluar, andaj përderisa sot po thirrresh në një përmbushje ligjore me sjelljen e këtij raporti, e dini se atëherë nuk e ke përmbushur një obligim ligjor dhe nëse nuk përmbushet një obligim ligjor atëherë është shkelje ligjore, ndërsa se sa është ky raporte sqarues, përmbajtësor dhe me të pathëna se si është shpenzuar buxheti lë shumë për të dëshiruar, shembull kemi disa shkurtesa / terme me shkronja të cilat nuk kuptohen por të njëjtat nuk figurojnë për sqarime se çfarë janë këto terme dhe këto anakronime sepse nuk jemi ekspert të fushës ne, përndryshe ka mundur të sqarohen në një faqe qysh në fillim të raportit, prandaj ka kundërshtime që ky raport nuk është sqarues.

Pastaj u përmend Raporti i Auditorit të Përgjithshëm, ne jemi në dijeni se ku e bënë një raport i tillë, pra një Institucion kredibil i pavarur me ekspert të fushës, por mos i jepni vetit të drejtë ta quajmë veten ekspert sepse nuk jemi, mund të jetë ndonjëri prej neve, por shumica e kuvendarëve nuk jemi ekspertë të fushës në këtë rast. Mandej mund të them se asgjë nga rekomandimet e Raportit të Auditorit të Përgjithshëm, nuk janë në këtë raport financiar e që ish dashtë të jenë.

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF, theksoi, ndoshta po e zgjatim paksa debatin në këtë çështje në këtë mbledhje të KPF-së, por e vërteta është se jemi audituar për vitin 2023, do të thotë kjo pasqyrë financiare për vitin 2023 është audituar, dhe do ta kemi raportin e Zyrës Kombëtare të Auditorit-ZKA ku do të përfshihen edhe të gjeturat, kështu që kjo është arsyeja që pa i marrë të gjeturat nga ZKA normalisht se nuk mund t'i paraqesim tek kjo pasqyrë financiare prandaj kjo ka qenë arsyeja. Në fakt është një praktikë ku zakonisht në raporte paraqiten të gjeturat e viteve paraprake, shembull ato të vitit 2022, por meqë është debatuar dhe janë prezantuar në Kuvend të gjeturat e ZKA-së për vitin 2022, nuk është parë e arsyeshme që sërish të prezantohen të njëjtat të gjetura për një dokument të cilin e kemi diskutuar në Kuvend të Komunes përfshirë edhe opinionin e ZKA-së për vitin 2022.

Pra kjo është formati zyrtar dhe mund të themi se edhe ne kemi kritika rreth formës së raportit që e aprovon Ministria e Financave dhe ZKA-së, prandaj kjo është raporti final me disa përmirësime gjatë fazës së auditimit të cilat janë të vërejtura, andaj mund të themi se kjo është pasqyra financiare e Komunes së Podujevës për vitin 2023.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, i nderuar drejtor, se është debatuar Raporti i Auditorit të jashtëm është obligim ligjor të sjellët në Kuvend për debat, mirëpo në këtë raport që po diskutojmë ne nuk kemi raportime as për të gjeturat e vitit 2022, madje as nuk kemi asgjë se sa prej atyre të gjeturave janë eliminuar ose janë përmirësuar në bazë të raportit të ZKA-së, pra jam duke fol për vitin 2022 sepse raportin e ZKA-së për vitin 2023 ende nuk e kemi diskutuar dhe nuk e dim ende cilat janë të gjeturat.

Nuk dëshiroj të zgjatem më shumë duke menduar se do ta debatojmë në Kuvend më gjerësisht, mirëpo vërtetë ky raport financiar për vitin 2023, është një raport i cili vetëm emrin raport e ka sepse nuk raporton dhe nuk sqaron asgjë.

**z.Bashkim Syla**, theksoi, kam edhe disa pyetje për drejtorin e DBF-së, ky raport a e pasqyron suficidin e qeverisjes lokale për vitin 2023, a është sakt pasqyrimi i suficidit për vitin 2023. E them këtë sepse nuk e kam të qartë tek pjesa e të hyrave vetanake ku mbi 1 milion euro janë pa shpenzuar në vitin 2023.

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF, theksoi, të hyra vetanake janë shpenzuar dhe paraqiten në raport financiar.



**z.Bashkim Syl**a, vazhdoi, a nuk ka mundësi që të hyrat vetanake të planifikohen për projekte të cilat janë më lehtë të realizueshme në mënyrë që të mos mbeten këto mjete të parealizuara dhe të mbetet suficid buxhetor pastaj, mirëpo po ndodh që të hyrat vetanake të planifikohen në projekte të mëdha dhe të mos realizohen pastaj, prandaj shtroj pyetje a ka mundësi që të hyrat vetanake të barten nga vitit 2023 në vitin 2024 dhe të mos mbeten mbi 1 milion euro sifcid.

Ta zëm, kemi për furnizim me ushqim, pije, jo dreka zyrtare 261,000.00€, prandaj a është e mundshme dhe e lejueshme të ceken në ndonjë rubrikë tjetër sikurse që janë investimet në arsim e që të ceket sakt shuma e ndarë, përndryshe kështu siç është neve nuk na jep sqarime asgjë ky raport, prandaj edhe detyrohem të parashtrijmë pyetje dhe kërkojmë sqarime për këto gjëra.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, kam pyetje konkrete për drejtorin e DBF, sa kemi suficid si Komunë e Podujevës në vitin 2023, a keni shifër, apo thënë ndryshe a kam arritur unë saktë të llogaris se suficidi është 1,326,716.00€.

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF, përgjigje parafolësit, theksoi, ajo është shuma e suficidit, por duke përfshirë edhe të hyrat vetanake të pashpenzuara.

**z.Naim Çunaku**, theksoi, i nderuar drejtor, kur bisedojmë për suficid aty hyjnë të gjitha shumatat buxhetore sepse buxheti final kur miratohet bëjnë pjesë edhe të hyrat, andaj edhe njëherë pyes a është e sakt shifra që kemi pasë suficid 1,326,716.00€.

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF, sërish përgjigje parafolësit, theksoi, ajo është shifra mirëpo do ta sqarojmë se sa janë nga grandit qeveritar dhe sa janë nga të hyrat vetanake, sepse është shumë me rëndësi sa janë nga të hyrat vetanake ajo që edhe z.Bashkim Syl a e potencoj sepse tani lidhet edhe me planifikimin buxhetor, mirëpo lidhet edhe me disa normativa dhe disa çështje ligjor të cilat i përcakton Ministria e Financave, shembull ne jemi në dijeni se shpërndajmë subvencione sakt mirëpo atë e kemi për obligim që pjesën më të madhe të subvencioneve t'i qesim prej të hyrave vetanake, sikur të ishte e kundërta dhe të na lejohet ne do t'i qitnim prej grandit por që nuk na lejohet, përjashtimisht disa çështjeve teknike ku disa mjete buxhetore nga grandit qeveritar t'i vëm tek subvencionet në bujqësi, prandaj kur vijnë tek planifikimi buxhetor do të mund të arrijmë atë që e ceku z.Bashkim Syl a e që do të bëjmë përpjekje maksimale, mirëpo çdo herë kur e planifikojmë buxhetin synimi është që të shpenzohet çdo projekt i cili është i mundshëm edhe pse në një formë e dim se është i pamundshëm, shembull ne planifikojmë buxhet për asfaltimin e rrugëve në 10 fshatra dhe zakonisht ka ndonjë ngecje kur kemi ndonjë ankesë në OSHP, andaj e kemi të pamundur që në fund të muajit shtatorit kur miratohet buxheti ta dim se cili projekt eventualisht mund të shkoj në OSHP dhe të ketë vonesa dhe çështje tjera ngase vetëm me këto pastaj shkaktohen suficidet, pra kjo është arsyeja.

**z.Bashkim Syl**a, theksoi, i nderuar drejtor i DBF-së, pajtoj plotësisht me ty mirëpo ju keni qe 3-4 vite në qeverisje dhe e dini se cilës Drejtori mund t'i mbetet suficid më shumë, ashtu siç e di edhe unë që më së shumti suficid i mbeten Drejtorisë së Urbanizmit dhe Drejtorisë së Shërbimeve Publike, andaj këto dy drejtori është mirë të menaxhohen.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, konsideroj se debati për këtë pikë të rendit të ditës debati përfundoj, andaj e vëm në votim që kjo pike e rendit të ditës t'i rekomandohet Kuvendit për diskutim.

*Njëzëri me 8 votë Për nga anëtarët që ishin prezent në sallë, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Kuvendit të Komunës i rekomandohet për diskutim të Raportit përkatës sipas materialit përkatës të kësaj pike dërguar me thirrjen e mbledhjes.*

**6. Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri – Projekti “Furnizim me mjete pune për ngritjen dhe zhvillimin e bizneseve”**

**z.Fatlum Osmani**, drejtor i DBF, e paraqiti raportin në fjalë, theksoi, në kuadër të projekteve kemi edhe projektin “Furnizim me mjete pune për ngritjen dhe zhvillimin e bizneseve” dhe për këtë është shpallë lista e përfituesve e që secili përfitues duhet të participoj me 30% të vlerës së pajisjes që do të furnizohen, andaj në këtë aspekt kemi obligim ligjor edhe nga Ministria e Financave që kur të barten mjetet buxhetore nga participimi të merret një vendim në Kuvendin e Komunës që këto mjete buxhetore nga participimi i qytetarëve t’i shtohen buxhetit për realizimin e këtij projekti që është prej kategorisë së subvencioneve, prandaj kjo është arsyeja përse është propozuar dhe duhet të miratohet ky vendim.

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedhim në votim edhe këtë propozim vendim që t’i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

*Njëzëri me 8 votë Për nga anëtarët që ishin prezent në sallë, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të propozim vendimit përkatës sipas materialit të kësaj pike dërguar me thirrjen e mbledhjes.*

**7. Plotësim ndryshimi përbërjes së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi-KKSB, përkatësisht z.Bashkim Bajrami Komandant i Stacionit të Policisë në Podujevë, të jetë anëtar në kuadër të përbërjes së KKSB në vend të ish Komandantit z.Nijazi Jashari i cili është pensionuar.**

**Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, pra kjo pikë e rendit të ditës hyri si pikë shtesë dhe u sqaruam në fillim të mbledhjes se për çka bëhet fjalë, andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedhim në votim edhe këtë propozim vendim që t’i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

*Njëzëri me 8 votë Për nga anëtarët që ishin prezent në sallë, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim dhe marrje të vendimit për Plotësim ndryshimin e përbërjes së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi-KKSB, përkatësisht që z.Bashkim Bajrami Komandant i Stacionit të Policisë në Podujevë, të jetë anëtar në kuadër të përbërjes së KKSB në vend të ish Komandantit z.Nijazi Jashari i cili është pensionuar.*

*Meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi i Komitetit e konstaton të përfunduar këtë mbledhje.*

**Mbledhja përfundoi në orën 10:55**

**Procesverbalin e mbajtën;  
Enis Sheholli**

**Nr.Prot.01-060/04-0020369/24  
Podujevë,  
28 mars 2024**

**Kryesuesi i Kuvendit - Komitetit  
Hilmi Hoxha**